

PROGRAMI I TRAJNIMIT

“AFTËSITË DIXHITALE TË DREJTUESVE TË RRJETEVE TE AMU”

Tiranë, Nëntor 2021

I. Qëllimi i Programit të Trajnimit

Programi i Trajnimit të Vazhduar për drejtuesit e rrjeteve të AMU në Shqipëri, i fokusuar te “Aftësitë dixhitale”, ka për qëllim të fuqizojë aftësitë e tyre për të planifikuar dhe realizuar veprimtari të rrjetit/komunikimin që bazohen në teknologjinë e informacionit, si dhe për zhvillimin e vazhduar profesional të anëtarëve të rrjetit në lidhje me teknologjinë e informacionit, si dhe për të zhvilluar më tej te nxënësit kompetencën dixhitale.

II. Kompetencat që fitojnë drejtuesit e rrjeteve në përfundim të Trajnimit

Pjesmarrësit do të jenë të aftë të:

- Planifikojnë veprimtaritë e rrjetit duke përdorur teknologjinë e informacionit.
- Përzgjedhin, përshtatin, vlerësojnë besueshmërinë e burimeve dixhitale të informacionit bazuar në kritere.
- Planifikojnë angazhimin e drejtuesve të rrjeteve për të përdorur burime dixhitale të informacionit.
- Themelojnë platforma online të komunikimit në google classroom/zoom.
- Organizojnë trajnime/workshope që të sigurojnë që anëtarët e rrjetit të përdorin platformën.
- Përdorin teknologjinë e informacionit, burime dixhitale për komunikimin dhe zhvillimin e vazhduar profesional.
- Organizojnë trajnime/workshope për përdorimin e teknologjisë së informacionit për vlerësimin e nxënësve.
- Organizojnë trajnime/workshope për përdorimin e teknologjisë së informacionit për zhvilluar strategji mësimdhënie gjithëpërfshirëse në lidhje me përdorimin e teknologjisë së informacionit.
- Organizojnë trajnime/workshope për përdorimin e teknologjisë së informacionit për procese mësimore që zhvillojnë aftësitë dixhitale të nxënësve.
- Organizojnë trajnime/workshope për përdorimin e teknologjisë së informacionit për të zbatuar rregullat e sigurisë në lidhje me rreziqet shëndetësore, kërcënimet dhe mirëqenien fizike dhe psikologjike personale dhe të nxënësve në lidhje me përdorimin e teknologjisë dixhitale.

III. Kohëzgjatja e Trajnimit

Kursi i Trajnimit ka një kohëzgjatje prej 4 ditësh trajnim x 6 orë/ditë = 24 orë trajnim të drejtpërdrejtë dhe 12 orë veprimtari online dhe në nivel të rrjetit.

V. Modulet e Trajnimit.

Nr	Titulli i Modullit	Kohëzgjatja	Rezultatet e pritshme
1	Përdorimi i teknologjisë së informacionit në planifikimin e veprimtarive të rrjetit	2 ditë trajnim i drejtperdrejtë (6 orë) 1 ditë veprimtari të pavarur (6 orë) Rekomandohet: 30% Teori 60% Praktikë 10% Vlerësime	1. Pjesmarrësi planifikon veprimtari të rrjetit bazuar në teknologjinë e informacionit. 2. Pjesmarrësi projektton dhe përshtat aktivitet bazuar në teknologjinë e informacionit 3. Pjesmarrësi planifikon dhe fuqizon anëtarët e rrjetit përmes teknologjisë 4. Pjesëmarrësi përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimin, bashkëpunimin mes mësuesve.
2	Përdorimi i teknologjisë për zhvillimin e vazhduar profesional të anëtarëve të rrjetit.	2 ditë trajnim (6 orë) Rekomandohet: 20% Teori 70% Praktikë 10% Vlerësime	1. Pjesëmarrësi përdor aftësitë digjitale në veprimtari të rrjetit që lidhen mësimdhënien dhe për materialet mësimore. 2. Pjesëmarrësi përdor aftësitë digjitale në veprimtari të rrjetit që lidhen me vlerësimin e vazhduar, testimin e njohurive dhe detyrave teorike

VI. Udhëzime për realizimin e Kursit të Trajnimit.

Trajnerët e Trajnimit të Vazhduar për trajnimin e drejtuesve të rrjeteve për Aftësitë digjitale duhet të përzgjedhin dhe përdorin forma dhe metoda mësimdhënieje të tilla që të nxisin maksimalisht të nxënit aktiv të pjesmarrësve dhe të çojnë në krijimin e ta, të kompetencave të plota dhe të qëndrueshme si mësues që përdorin në mënyrë të suksesshme teknologjinë e informacionit.

Trajnerët duhet të përdorin forma dhe metoda trajnimi që zhvillojnë shprehinë praktike dixhitale të pjesmarrësve. Integrimi i teorisë me praktikën, shpjegimet e ilustruara, puna në grup, dhënia e detyrave, demonstrimet praktike, diskutimet në grupe etj., duhet të jenë format dhe metodat bazë të këtij trajnimi.

Secili pjesmarrës duhet të krijojë “portofolin” e trajnimit i cili përmban dokumentimin e veprimtarive dhe arritjeve të pjesmarrësit dhe që shërben, si për vlerësimin e tij përfundimtar, ashtu edhe për lehtësimin e zbatimit të aftësive të fituara në praktikën e ardhshme mësimore. Dhënia e detyrave dhe puna e pavarur e pjesmarrësve ka një ndikim të dukshëm në zhvillimin e kompetencave mësimdhënëse të mësuesve dhe instruktorëve pjesmarrës në trajnim.

VIII. Përshkruesit e Moduleve të Kursit të Trajnimit të Vazhduar për Aftësitë digjitale të drejtuesve të rrjeteve.

1. Moduli “Përdorimi i teknologjisë së informacionit në planifikimin e mësimdhënies”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi i Modullit	Përdorimi i teknologjisë së informacionit në planifikimin e mësimdhënies	
Qëllimi i modullit	Nëpërmjet këtij moduli pjesmarrësit njihen me përdorimin e burimeve të besueshme, përshtatjen e tyre për qëllime mësimore si dhe planifikimin e veprimtarive që zhvillojnë aftësitë dixhitale të nxënësit	
Kohëzgjatja e Modullit	2 ditë (12 orë) trajnim	
Rezultatet e të Mësuarit (RM)	RM1: Pjesmarrësi planifikon veprimtaritë e rrjetit bazuar në teknologjinë e informacionit. RM2: Pjesmarrësi projektin dhe përshtat aktivitetin e rrjetit bazuar në teknologjinë e informacionit RM3: Pjesmarrësi planifikon dhe fuqizon anëtarët e rrjetit përmes teknologjisë RM4: Pjesëmarrësi përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimin, bashkëpunimin mes mësuesve.	
RM1	Pjesmarrësi planifikon v beprimtaritë e rrjetit bazuar në teknologjinë e informacionit. Çështjet dhe veprimtaritë kryesore: - Formulimi i strategjive të kërkimit për të identifikuar burimet dixhitale për mësimdhënie dhe nxënie. - Përzgjedhja e burimeve të përshtatshme dixhitale për mësimdhënie dhe nxënie, duke marrë parasysh kontekstin specifik të të nxënësit dhe objektivin e të mësuarit. - Vlerësimi në mënyrë kritike i besueshmërinë së burimeve dixhitale. - Kufizimet e mundshme të përdorimit ose ripërdorimit të burimeve dixhitale (p.sh. e drejta e kopjimit, lloji i skedarit, kërkesat teknike, dispozitat ligjore, mundësia e hyrjes). - Vlerësimi i dobisë së burimeve dixhitale në adresimin e objektivit të të nxënësit, nivelet e kompetencës, si dhe qasjen e zgjedhur të mësimdhënies.	
RM2	Pjesmarrësi projektin dhe përshtat aktivitetin e rrjetit bazuar në teknologjinë e informacionit Çështjet dhe veprimtaritë kryesore: - Përshtatja dhe ndryshimi i burimeve dixhitale, kur është e lejuar. - Kombinimi i burimeve ekzistuese dixhitale ose pjesë të tyre, kur lejohet. - Krijimi i burimeve të reja arsimore dixhitale. - Krijimi së bashku me të tjerë burime arsimore dixhitale.	

	Konsideroni objektivin specifik të të mësuarit, kontekstin, qasjen e mësimdhënies dhe grupin e nxënësit, kur përshtatni ose krijoni burime dixhitale të të mësuarit.
RM3	Pjesmarrësi planifikon dhe fuqizon anëtarët e rrjetit përmes teknologjisë <i>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</i> - Planifikimi i aktiviteteve të përshtatshme si detyra dhe vlerësime, për të siguruar mbështetjen e nxënësit me aftësi të ndryshme të shkrim-leximit dixhital. - Përfshirja e aktiviteteve, detyrave dhe vlerësimeve të të nxënësit që inkurajojnë dhe kërkojnë nga nxënësit të: - Artikulojnë nevojat për informacion, për të kërkuar të dhëna, informacione dhe përmbajtje në mjediset dixhitale, për t'i hyrë në to dhe për të lundruar midis tyre. - Krijimi dhe përditësimi i strategjive personale të kërkimit. - Përshtatja e strategjive të kërkimit bazuar në cilësinë e informacionit të gjetur. - Analizimi, krahasimi dhe vlerësimi në mënyrë kritike I besueshmërisë dhe vërtetësisë së burimeve të të dhënave, informacionit dhe përmbajtjes dixhitale. - Organizimi, ruajtja dhe marrja e të dhënave, informacioneve dhe përmbajtjeve në mjediset dixhitale. - Organizimi dhe përpunimi i informacionit në një mjedis të strukturuar.
RM4	Pjesëmarrësi përdor teknologjinë e informacionit dhe komunikimin, bashkëpunimin mes mësuesve. <i>Çështjet dhe veprimtaritë kryesore:</i> - Shkëmbimi i informacionit, burimeve dhe përvojave me kolegët duke përdorur teknologjinë dixhitale. - Zhvillimi i materialeve educative në bashkëpunim me kolegët duke përdorur teknologjinë dixhitale. - Përfshirja e materiale mësimore, detyra dhe vlerësime të cilat inkurajojnë nxënësit të përdorin teknologjinë dixhitale duke ndarë dhe duke ndërtuar informacion dhe materiale në bashkëpunim me kolegët. - Mbështetja e nxënësve të organizojnë komunikimet e tyre në internet. - Mbështetja e nxënësve të komunikojnë më mirë me kolegët dhe ekspertët. - Mbështetja e nxënësve të angazhohen në një bashkëpunim efektiv në internet. - Mbështetja e nxënësve të kryejnë një komunikim dixhital të sigurt dhe të përshtatshëm. - Mbështetja e nxënësve të bëhen komunikues të fuqishëm dhe etikë në internet.

2. Moduli “Zhvillim i strategjive të zhvillimit të vazhduar të anëtarëve të rrjetit dhe promovimi i identitetit dixhital të sigurt dhe komod”

PERSHKRUESI I MODULIT		
Titulli dhe Kodi i Modullit	Zhvillim i strategjive të ZHVP dhe promovimi i identitetit dixhital të sigurt dhe komod	
Qëllimi i Modullit	Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit aftësohen për zhvillimin e vazhduar profesional	
Kohëzgjatja e Modullit	2 ditë (12 orë) trajnimi	
Rezultatet e të Mësuarit (RM)	RM1: Pjesëmarrësi përdor aftësitë digjitale në veprimtari të rrjetit që lidhen mësimdhënien dhe për materialet mësimore. RM2: Pjesëmarrësi përdor aftësitë digjitale në veprimtari të rrjetit që lidhen me vlerësimin e vazhduar, testimin e njohurive dhe detyrave teorike.	
RM1	Pjesëmarrësi përdor aftësitë digjitale në veprimtari të rrjetit që lidhen mësimdhënien dhe për materialet mësimore. Çështjet dhe veprimtaritë kryesore: • Reflektimi në mënyrë kritike mbi të nxënit dhe praktikat dixhitale. • Identifikimi i boshllëqeve dhe fushat për përmirësim. • Plani i ndihmës për përmirësimin e mësimdhënies dhe praktikës dixhitale. • Fushat e nevojshme të trajnimeve si mundësi për zhvillim të vazhdueshëm profesional. • Mundësitë për zgjerimin dhe përmirësimin e repertorit të praktikave dixhitale të mësimdhënies. • Plani për shkëmbim dhe mbështetje në zhvillimin e kompetencës dixhitale të mësimdhënies. • Kontributi në zhvillimin e praktikave, politikave dhe vizioneve organizative mbi përdorimin e teknologjive dixhitale. • Rrjetet bashkëpunuese profesionale për të eksploruar dhe reflektuar mbi praktikat dhe metodat e reja të mësimdhënies. • Burimet në internet ose mediat sociale për të identifikuar mundësi të përshtatshme trajnimi dhe zhvillimi profesional. • Burimet në internet ose mediat sociale për të përditësuar kompetencat specifike të lëndës. • Burimet në internet ose mediat sociale për të mësuar në lidhje me metodat dhe strategjitë e reja të mësimdhënies. • Burimet në internet ose mediat sociale për të kërkuar dhe identifikuar burimet dixhitale të cilat mbështesin zhvillimin profesional. • Shkëmbimin në forumet profesionale dixhitale si një burim i zhvillimit profesional. • Trajnimi në internet, p.sh. udhëzime për video, uebinar etj.	

	• Përditësimi i kompetencave specifike të lëndës online. • Përditësimi i metodave dhe strategjive të reja të mësimdhënies. • Burimet dixhitale që mbështesin zhvillimin profesional brenda fushës suaj specifike të lëndës.
RM2	Pjesëmarrësi përdor aftësitë digjitale në veprimtari të rrjetit që lidhen me vlerësimin e vazhduar, testimin e njohurive dhe detyrave teorike. <i>Çështjet dhe veprimtari të kryesore:</i> • Reflektimi në mënyrë kritike mbi të vlerësimin. • Identifikimi i boshllëqeve për vlerësimin dhe fushat për përmirësim. • Plani i trajnimeve për vlerësimin e nxënësit dhe dhenien e feedbackut në mënyrë digjitale • Fushat e nevojshme të trajnimeve për vlerësimin si mundësi për zhvillim të vazhdueshëm profesional. • Monitorimi dhe vlerësimi i sjelljes digjitale të nxënësit në mjediset dixhitale në mënyrë që të mbrojnë mirëqenien e tyre. • Reagimi kur mirëqenia e nxënësve kërcënohet në mjediset dixhitale (p.sh. ngacmimi në internet).